

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6338
E martë, 15 qershor 2021
çmimi 0.40 €

Opozita kërkon nga qeveria ta zbatojë Ligjin për rimëkëmbje ekonomike

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA SHKARKUAR TË HËNËN VALDETE DAKËN NGA POZITA E KRYETARES SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) | FAQE 3

PUSHTETI KAP NË DORË EDHE KQZ-në



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka emëruar gjyqtarin Kreshnik Radoniqi kryetar të ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), pas ndërprerjes së mandatit të kryesueses së deritanishme të KQZ-së, Valdete Daka. Në vendimin e presidentes Vjosa Osmani për shkarkimin e Dakës thuhet se kryesuesja e KQZ-së ka cenuar integritetin dhe besimin e qytetarëve ndaj KQZ-së. Albert Krasniqi nga "Demokracia Plus" ka thënë se Kushtetua nuk ka paraparë si kompetencë të presidentit shkarkimin e kryesuesit të KQZ-së, por vetëm emërimin. "Këto ngjarje nuk mund të quhen ndryshe përveçse orvatje për kapje të KQZ-së", ka thënë Krasniqi

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

KOSOVA KA BËRË MJAFT KOMPROMISE, RADHËN E KA SERBIA



Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se Kosova ka bërë mjaft kompromise në raport me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se Kosova nuk duhet ta bëjë asnjë kompromis në fazën finale të dialogut me Serbinë. Sipas saj, tani është radha e Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës. Tahiri ka thënë se takimi i parë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit është vazhdim i procesit të dialogut dhe jo një fillim i ri ashtu siç po pretendon kryeministri Kurti



BIDENI SIGURON ALEATËT E NATO-S PËR 'MBROJTJEN RECIPROKE'

FAQE 2

OPINION

PËR VJOSËN PA KUJTESË, PËR DONIKËN QË S'KUPTON DHE PËR DY BURRA BANALË

F. 6

Shkruan:
Baton HAXHIU



AKTUALE



KURTI SOT TAKOHET ME VUÇIQIN NË BRUKSEL

F. 5

PESË RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË, ASNJË I VDEKUR

F. 5

EKONOMI

SEKTORI I FURNIZIMIT ME RRYMË SHËNON RITJË

F. 9

OAK-U: QEVERIA TË KETË MENAXHIM MË TË MIRË TË PARASË DHE PRONËS PUBLIKE

F. 9



SPORT

ERIKSEN: DUA TË KUPTOJ SE ÇFARË NDODHI, DO TË RIKTHEHEM NË STËRVITJE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni siguron aleatët e NATO-s për 'mbrojtjen reciproke'

BRUKSEL, 14 QERSHOR- Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se NATO-ja është "shumë e rëndësishme" për interesat amerikane. Sipas tij klauzola e NATO-s për mbrojtje reciproke është "një detyrim i shenjtë". Biden i bëri komentet pasi mbërriti në Bruksel për një samit me udhëheqësit e NATO-s.

Presidenti amerikan tha se ai dëshiron që Evropa ta kuptojë se ShBA-ja qëndron pranë saj. Pjesëmarrja e presidentit Biden në samitin e NATO-s është pjesë e një turneu evropian që ka për qëllim përmirësimin e raporteve transatlantike, të lëkundura gjatë udhëheqjes së paraardhësit të tij, Donald



Trump. Duke folur para gazetarëve para fillimit të samitit,

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u bëri thirrje vendeve anëtare që

t'i përgjigjen rritjes së ndikimit të Kinës. "Ne nuk po hyjmë në një Luftë të re të Ftohtë dhe Kina nuk është kundërshtari ynë, as armiku ynë", u tha Stoltenberg gazetarëve në selinë e NATO-s.

Udhëheqësit e NATO-s pritët të lëshojnë një deklaratë, në të cilën Kina do të etiketohet si rrezik për sigurinë.

Rusia është gjithashtu një nga pikat kryesore të agjendës së samitit të NATO-s.

Që nga marrja e detyrës në janar, Biden e ka kritikuar Moskën për rolin e saj në konfliktin e Ukrainës, ndërhyrjen e pretenduar të Rusisë në zgjedhjet e vendeve të tjera dhe sulmet kibernetike

nga hakerët me bazë në Rusi. Nga Brukseli, Biden do të udhëtojë në Gjenevë të Zvicrës ku do të takojë presidentin rus, Vladimir Putin.

Takimi mes dy liderëve mbahet më 16 qershor.

Jamie Shea është president i Qendrës për Studime të Luftës. Ai ka qenë një zyrtar i NATO-s për gati katër dekada para se të largohet nga organizata më 2018.

Shea thotë se pavarësisht shumë temave të rëndësishme që udhëheqësit e NATO-s duhet të trajtojnë, detyra kryesore për presidentin Biden është që thjesht të rikonfirmojë angazhimin e Uashingtonit për mbrojtjen e NATO-s.

Merr fund epoka e Netanyahu

JERUSALEM, 14 QERSHOR- Pas 12 vjetësh në pushtet, Benjamin Netanyahu humbi postin e kryeministrit pasi Parlamenti i Izraelit votoi një qeveri të re të koalicionit.

Nga 120 deputetët e Parlamentit të Izraelit, pro kabinetit të ri qeveritar votuan 60 ndërsa 59 ishin kundër.

Qeveria e re do të drejtohet nga nacionalisti i krahut të djathtë, Naftali Bennett, nga partia Yamina, i cili u betua në postin e kryeministrit dhe do të drejtojë një koalicion të

gjerë të partive.

Bennett ka një marrëveshje për ndarjen e pushtetit me një udhëheqës të një partie të qendrës.

Sipas marrëveshjes së koalicionit, Bennett, i cili udhëheq partinë Yamina, do të ushtrojë postin e kryeministrit deri në shtator të vitit 2023, dhe më pas do t'ia dorëzojë atë, Yair Lapid, udhëheqësit të partisë Yesh Atid.

Netanyahu, si kreu i partisë së djathtë Likud do të jetë lider i

opozitës.

Më herët ai e ka sulmuar qeverinë e re, duke e quajtur atë një "koalicion të rrezikshëm mashtrimi dhe dorëzimi" dhe është zotuar se do ta "rrëzojë shumë shpejt". Ndaj Netanyahu po vazhdon gjyqi lidhur me akuzat për rryshfet, mashtrim dhe shkelje të besimit. Ai i mohon akuzat. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se ShBA-ja mbetet e përkushtuar për sigurinë e Izraelit dhe do të punojnë me qeverinë e re.



Kina dënon deklaratën e grupit G7



Pekin, 14 qershor- Ambasada e Kinës në Londër e dënoi një deklaratë të grupit të vendeve më të industrializuara (G7), duke e cilësuar si "ndërhyrje brute" në punët e brendshme të Kinës.

G7 e akuzoi Kinën për shkelje të të drejtave të njeriut në Ksinjiang dhe Hong Kong.

Shtetet e Bashkuara kanë përdorur fjalën gjenocid për të

përshkruar trajtimin e ujqurëve dhe pakicave të tjera myslimane në Ksinjiang.

G7 duhet të bëjë më shumë për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të mos krijojë artificialisht konfrontime dhe fërkime, tha Ambasada e Kinës në Londër. Deklarata e akuzoi G7-n për "gënjeshtër, thashetheme dhe pretendime të

pabazuara". "G7 përfiton nga çështjet e lidhura me Ksinjiangun për t'u përfshirë në manipulime politike dhe për të ndërhyrë në punët e brendshme të Kinës", tha një zëdhënës i Ambasadës.

Kina besohet se ka ndaluar më shumë se një milion ujqurë dhe myslimanë të tjerë në rajonin Ksinjiang.

Shumica e tyre dërgohen në të ashtuquajturat kampe "riedukimi", ku mbahen për kohë të pacaktuar dhe pa ndonjë akuzë.

Kina fillimisht e ka mohuar ekzistencën e kampeve, ndërsa ma vonë ka thënë se ato janë të nevojshme për të luftuar terrorizmin.

Kina i ka hedhur poshtë akuzat

për abuzime me të drejta të njeriut.

Hong Kongu, në anën tjetër, është pjesë e Kinës, por funksionin nën kornizën "një vend, dy sisteme", çfarë do të thotë se ai e ka sistemin e tij ligjor. Shumë në Hong Kong, por edhe në Perëndim, e akuzojnë Pekinin për shkatërrimin e autonomisë së rajonit në vitet e fundit.

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA SHKARKUAR TË HËNËN VALDETE DAKËN NGA POZITA E KRYETARES SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)

Pushteti kap në dorë edhe KQZ-në

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka emëruar gjyqtarin Kreshnik Radoniqi kryetar të ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), pas ndërprerjes së mandatit të kryesueses së deritanishme të KQZ-së, Valdete Daka. Në vendimin e presidentes Vjosa Osmani për shkarkimin e Dakës thuhet se kryesuesja e KQZ-së ka cenuar integritetin dhe besimin e qytetarëve ndaj KQZ-së. Albert Krasniqi nga "Demokracia Plus" ka thënë se Kushtetua nuk ka paraparë si kompetencë të presidentit shkarkimin e kryesuesit të KQZ-së, por vetëm emërimin. "Këto ngjarje nuk mund të quhen ndryshe përveçse orvatje për kapje të KQZ-së", ka thënë Krasniqi



respektuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

"Personi i cili në KQZ po ndikon, që edhe kërkesa të jetë sugjестive e kundër Albin Kurtit, është Valdete Daka. Kurtigjë ata nuk po zbatojnë. Ata po duan eliminim politik", pati deklaruar Konjufca.

Edhe anëtari i Kryesisë i Lëvizjes Vetëvendosje, Xhelal Sveçla, tash ministër i Punëve të Brendshme pati reaguar pas deklarimit të Dakës se ndihet e kërcënuar. Sveçla ka thënë se Daka duhet ta dijë se nuk është viti 2020, kur presidenti i Kosovës ishte Hashim Thaçi dhe se "Kosova tash ka presidente të re, znj. Vjosa Osmani". Ai, po ashtu, pati thënë se Daka "nuk nuk bën që preferencën e saj personale ta keqpërdorë si kryetare e KQZ-së".

Daka është emëruar kryetare e KQZ-së më 27 prill të vitit 2018 nga ish-presidenti Hashim Thaçi, ndërkaq mandati i saj është pesëvjeçar. Ky ishte mandati i dytë i Dakës në krye të KQZ-së.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shkarkuar të hënën Valdete Dakën nga pozita e kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në njoftimin e Presidencës theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i pavarur kushtetues dhe përgjegjësi për ta ruajtur pavarësinë e KQZ-së së pari është përgjegjësi e kryesuesit të Komisionit. "Kryesuesi i KQZ-së nuk vjen nga radhët e partive politike, por emërimi i tij bëhet me një proces të veçantë, fakt ky i cili tregon se kryesuesi duhet të jetë i pavarur në veprimet e tij edhe kur brenda KQZ-së mund të ketë presione nga subjektet politike. Në procesin e fundit zgjedhor, KQZ ka qenë e polarizuar dhe mbledhjet e vendimarrja janë shoqëruar me tensione si kurrë më parë. Kryesuesja e KQZ-së, në shumë raste, nuk ka arritur të jetë forcë e pavarur ndaj polarizimeve politike dhe që vendimarrja e saj të drejtohet nga interesi i përgjithshëm publik, e që për rrjedhojë ka cenuar integritetin dhe besimin e qytetarëve ndaj KQZ-së. Presidentja Osmani vlerëson se veprimet e kryesueses së KQZ-së nuk duhet të jenë shkakuar për

humbjen e besimit qytetar ndaj institucionit, në veçanti pasi sivjet do të mbahen zgjedhjet lokale", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Në këtë njoftim theksohet se legjislacioni në fuqi parasheh se presidentja është autoriteti kompetent për ta emëruar kryesuesen e KQZ-së sikurse edhe për ndërprerje të mandatit të saj. "Ndaj, presidentja ka nxjerrë vendimin për lirimin nga detyra të znj. Valdete Daka, duke pasur në konsideratë vlerat demokratike të integruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe duke pasur parasysh se pavarësia dhe integriteti i KQZ-së kanë një rëndësi vitale në zgjedhjet demokratike", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Albert Krasniqi nga "Demokracia Plus" ka thënë se Kushtetua nuk ka paraparë si kompetencë të presidentit shkarkimin e kryesuesit të KQZ-së, por vetëm emërimin. "Kushtetua nuk ka paraparë si kompetencë të presidentit shkarkimin e kryesuesit të KQZ-së, por vetëm emërimin", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka pohuar se: "Në vend të mbrojtjes dhe garantimit të funksionimit kushtetues të KQZ-së, presidentja po bën të kundërtën, po e pengon atë. Këto ngjarje nuk mund të quhen ndryshe përveçse

orvatje për kapje të KQZ-së", ka thënë Krasniqi.

Daka para disa muajve kishte mbajtur një konferencë për media në të cilën pati deklaruar se po i vijonë kërcënime nga LV-ja. "Shqetësimet që po i përjeton familja ime janë të paprecedente dhe të rrezikshme", pati deklaruar ajo.

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, tash kryetar i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, gjatë një emisioni në "Tv Dukagjini", më 20 janar, pati deklaruar në lidhje me moscertifikimin e 47 deputetëve, përfshirë këtu edhe kreun e partisë së tij, Albin Kurti, po bëhet për eliminime politike dhe për ta

Kreshnik Radoniqi, kryetar i ri i KQZ-së



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, e ka emëruar gjyqtarin Kreshnik Radoniqi kryetar të ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), pas ndërprerjes së mandatit të kryesueses së deritanishme të KQZ-së, Valdete Daka. "Kreshnik Radoniqi është gjyqtar në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit. Gjyqtari Radoniqi në vitin 2006 ka diplomuar në Fakultetin Juridik të

Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitin 2013 ka përfunduar studimet master në ShBA. Provimin e jurisprudencës e përfundoi më 2007. Radoniqi konsiderohet gjyqtar me kredibilitet të lartë profesional dhe paanshmëri në vendimarrje. Emërimi i gjyqtarit Kreshnik Radoniqi kryesues i ri i KQZ-së do të sigurojë që integriteti i KQZ-së nuk dëmtohet më tutje si dhe

do të mundësojë mbarëvajtjen e organizimit të zgjedhjeve lokale të bazuar në gjithëpërfshirjen e votuesve në ditën e zgjedhjeve brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës. Presidentja Osmani i ka uruar punë të mbarë z. Radoniqi, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së integritetit të KQZ-së dhe funksionimit të tij në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet për zgjedhje", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Haki Rugova dënohet me një vjet burgim për konflikt interesi

ISTOG, 14 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, është dënuar me një vjet burgim efektiv. Aktakuza ndaj tij ishte ngritur më 26 mars të vitit 2018 nga Prokuroria Themelore në Gjakovë.

Rugova akuzohej për konflikt interesi pasi, duke vepruar si kryetar i komunës, ka nënshkruar një kontratë me një firmën të cilën e drejtonte vëllai i tij, Gani Rugova, raporton "Betimi për Drejtësi". "Në momentin e

lidhjes së kontratës për kryerjen e punëve ndërtimore në mes të Komunës së Istogut dhe kompanisë 'Ma-Con' sh.p.k. dhe çmimi i kontratës ka qenë 289,119.85 euro", thuhej në aktakuzë. Kontrata kishte të bënte me

ndërtimin e kanalizimit për fshatrat Cercë dhe Lubozhdë. Besnik Berisha, avokat mbrojtës i të akuzuarit, ka argumentuar se, bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik, për kontratat e mesme nuk ishte e nevojshme

nënshkrimi i kryetarit e që, sipas tij, kjo kontratë ka qenë e tillë.

Haki Rugova në zgjedhjet lokale të vitit 2017 kishte fituar edhe një mandat tjetër, për herë të tretë, në krye të Komunës së Istogut.



FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Kosova ka bërë mjaft kompromise, radhën e ka Serbia

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se Kosova ka bërë mjaft kompromise në raport me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se Kosova nuk duhet ta bëjë asnjë kompromis në fazën finale të dialogut me Serbinë. Sipas saj, tani është radha e Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës. Tahiri ka thënë se takimi i parë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit është vazhdim i procesit të dialogut dhe jo një fillim i ri ashtu siç po pretendon kryeministri Kurti

e suksesionit. Me fjalë të tjera, Kosova duhet ta kërkojë pasurinë që i takon nga ish-Jugosllavia, sepse ka qenë një nga tetë njësitet federale. Kjo i takon Kosovës në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Në bazë të këtyre tri parimeve të së drejtës ndërkombëtare si dhe në bazë të platformës së Kosovës dhe në respektim të Kushtetutës së Kosovës, duhet të ketë edhe një pjesë të marrëveshjes ku mund të flitet për bashkëpunimet ndërshtetërore sipas interesave të ndërsjella. Ndërsa për minoritetin serb në Kosovë vijë e kuqe është plani i Ahtisarit. Pra, nuk duhet të jepet më shumë pavarësisht që Serbia kërkon kompromise të reja.

Retorika e Serbisë për kompromise është një retorikë që provon ta barazojë agresorin me viktimën dhe kjo nuk duhet të lejohet, sepse Serbia ka bërë

luftë agresore deri në gjenocid. Në këtë proces Kosova nuk ka se çfarë të bëjë kompromis, sepse kompromisi që ka bërë Kosova është gjaku i derdhur për liri dhe pavarësi dhe, po ashtu, kompromiset që janë bërë në Konferencën e Rambujesë dhe bisedimet e Vjenës. Më shumë nuk mund të bëjë Kosova. Tani është radha e Serbisë ta bëjë kompromisin, ta njohë pavarësinë e Kosovës.

"Epoka e re": Qëndrimi i kryeministrit Kurti është se ky takim nuk do të jetë një vazhdim i procesit të deritanishëm të dialogut, por një fillim i ri. Si e keni parë këtë qëndrim të kryeministrit?

Tahiri: Kjo është vetëm një lojë fjalësh, sepse nuk ka ndonjë rëndësi kjo deklaratë. Praktikisht ky dialog ka filluar në vitin 2011, pra është një proces në

vazhdimësi që tani ka hyrë në fazën finale. Pavarësisht se çfarë deklaron Kurti për opinion apo për konsum të brendshëm, ky është vazhdim i dialogut të Brukselit.

"Epoka e re": Në raportimin për dialogun në Kuvend, kryeministri ka kritikuar marrëveshjet që janë arritur në këtë proces, të cilat i keni negociuar edhe ju. Cila është përgjigja juaj?

Tahiri: Së pari dua të theksoj se më ka ardhur mirë që kanë bërë vlerësimin e gjithë procesit të dialogut për atë që kanë mundur. Atë që nuk e pashë në këtë raport ishte se gjatë gjithë kohës sa z. Kurti ka qenë në opozitë ka thënë se marrëveshjet kanë shkelur ligjet e Kosovës dhe Kushtetutën. Ndërsa, gjatë fjalimit në Kuvend, kryeministri në asnjë çast nuk tha se janë

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 QERSHOR -

"Epoka e re": Znj. Tahiri, vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi do të ndodhë këtë të martë. Cilat janë pritjet tuaja nga ky takim?

Tahiri: Është me rëndësi që dialogu i Brukselit ka hyrë në fazën finale të tij dhe në këtë

proces pritet të arrihet marrëveshja përfundimtare e cila marrëveshje në thelb duhet të ketë njohjen reciproke mes dy shteteve në kufijtë aktualë. Kjo marrëveshje duhet t'i përmbajë çështjet e reparacioneve të luftës, pra të gjitha dëmshpërblimet e luftës që Serbia duhet t'ia bëjë Kosovës për gjithë gjenocidin që ka bërë në Kosovë. Gjithashtu, marrëveshja duhet ta ketë pjesën

shkelur ligjet dhe Kushtetuta e Kosovës. Me fjalë të tjera, ai pranoi se të gjitha marrëveshjet janë në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Për vërejtjet që i kanë pasur, unë dua të them se është e rëndësishme që dialogu ka arritur ta integrojë verium e Kosovës në sistemin shtetëror të Kosovës. Falë bisedimeve në Bruksel, ne sot kemi gjykatat e Kosovës në veri të vendit, kemi policinë në veri të vendit dhe kemi vënë kufirin shtetëror në mes të Kosovës dhe Serbisë në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat kanë qenë të djegura para dialogut. Pra, kemi bërë shtrirjen e institucioneve shtetërore në të gjitha fushat në veri të vendit. Gjithashtu, kemi bërë shuarjen e strukturave paralele në të gjitha fushat, si në: polici, dogana, gjykata, prokurori, energji, telekom dhe në fusha të tjera. Ky dialog i ka sjellë Kosovës pavarësinë energjetike dhe kodin shtetëror telefonik. Falë këtij procesi dhe fusnotës që kritikohet, Kosova ka arritur të hyjë në rrugën zyrtare të integrimi evropiane me

nënshkrimin e MSA-së me BE-në. Pikërisht kjo fusnotë ka bërë që pesë vendet mosnjohje të BE-së e kanë përkrahur integrimin zyrtar të Kosovës në BE përmes MSA-së.

“Epoka e re”: Edhe kjo qeveri po shkon në Bruksel pa një konsensus nacional. Sa e dëmton kjo pozicionin e Kosovës në këtë proces?

Tahiri: Është për keqardhje që nuk ka një konsensus më të gjerë dhe një bashkëpunim më të mirë mes qeverisë dhe opozitës në këtë proces, sepse kjo është faza përfundimtare e dialogut ku duhet të ketë një pjesëmarrje edhe të opozitës në delegacionin për bisedimet e Brukselit. Shpresoj që në të ardhmen ta kemi një bashkëpunim të tillë.

“Epoka e re”: Gjithashtu, qeveria ende nuk ka paraqitur një platformë për këto bisedime?

Tahiri: Mungesa e platformës është një dështim i qeverisë. Nuk mund të shkohet në një dialog me kaq rëndësi të madhe kombëtare dhe qeveria të mos ketë një platformë për këto bisedime.

“Epoka e re”: Zëvendëskryeministri Bislimi ka ftuar në takim pothuajse të gjithë ish-zyrtarët shtetërorë që kanë qenë të inkuadruar në dialog. Keni pasur ju ftesë?

Tahiri: Më ka ftuar, por nuk kam shkuar në takim. I kam thënë se për çfarëdo që të këtë nevojë të më shkruajë me shkrim dhe unë do t'i përgjigjem.

Nga kabineti i Bislimit më kanë kërkuar disa shpjegime në lidhje me disa dokumente. Natyrisht se unë ua kam dhënë shpjegimet dhe disa këshillime me shkrim. Gjithashtu, kam pasur ofertë të jem pesë e ekipit të ekspertëve që është krijuar nga ndërkombehtarët. E kam refuzuar ftesën, sepse nuk më ka pëlqyer oferta. Nuk mund të jem një këshilltar në delegacionin e Brukselit, sepse për këto 30 vjet sa kam qenë e kyçur në procesin e çlirimit dhe pavarësimin të Kosovës, unë kam qenë lidere vendimmarrëse dhe nuk mund të kaloj tani në pozitë të këshilltares. Pra, nuk ka pasur një ofertë më serioze, prandaj ajo që më është ofruar e kam refuzuar.

Kurti sot takohet me Vuçiqin në Bruksel

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Bislim Bislimi, ka udhëtuar të hënën për në Bruksel, ku sot (e martë) do ta zhvillojë takimin e parë të tij si kryeministër me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka thënë se ky takim mes Kurtit dhe Vuçiqit nuk është takim i dialogut, por takim për dialogun e ardhshëm. “Aty kryeministri Kurti do ta paraqesë vizionin dhe qëndrimet tij dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të, e i cili duhet të jetë parimor dhe i drejtë, në shërbim të popujve të



dy vendeve dhe i shkëputur nga ai i kaluari. Pra nga takimi synohet dakordim rreth kapitullit të ardhshëm të dialogut dhe agjendës së tij, pas diskutimeve shteruese të ditës

së premtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për dialogun e mëparshëm dhe dëmet e shkaktuar nga ai”, ka shkruar Kryeziu në llogarinë e vet në “Facebook”.

Pesë raste të reja me Covid në Kosovë, asnjë i vdekur

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 1 977 testime, pesë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të hënën janë shëruar 94 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 104 988. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 345. MSH-



ja ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 1 117 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 99 394 doza të vaksinës. Deri më sot 9 640 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Pjesëtarët e Njësive të Specializuara të Policisë së Kosovës dhurojnë gjak

Prishtinë, 14 qershor (ER) - Të hënën në sheshin “Nënë Tereza”, me rastin e Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut, pjesëtarët e Njësive të Specializuara të Policisë së Kosovës - NJSO kanë dalë për të dhuruar gjak vullnetarisht. “Dhurimi vullnetar i gjakut është vepër humane,

prandaj zyrtarët e policisë gjithnjë shprehin gatishtëri të jenë në shërbim të qytetarëve të vendit”, theksohet në njoftimin për media të Policisë së Kosovës. Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore e PK-së në bashkëpunim me QKKTGJ-në.





Shkruan: Baton HAXHIU

Për Vjosën pa kujtesë, për Donikën që s'kupton dhe për dy burra banalë

Nuk kam dashur të shkruaj për luftën. Ka kohë që e kam kuptuar që një pjesë e shoqërisë kosovare dëshiron ta harrojë. Disa të tjerë dëshirojnë ta përdorin si madhërim të pakufishëm. Dhe një pjesë tjetër janë barbarë në diskurs - të gatshëm për ta vrarë edhe lirinë që ka sjell lufta jonë dhe UÇK-ja.

Pushteti i Vjosës dhe Albinit po krijon fuqi për të ndaluar dhe jo për të krijuar gjëra të reja. Po vret kujtesën për lirinë dhe po viktimizohet, duke shkuar tek secili varr, pa ndryshuar gjë nga fjalori.

Lufta për liri, si momenti më sublim i historisë së Kosovës, po trajtohet edhe nga banalistë me gjuhë barbare. Sidomos nga dy burra të veshur me pushtet të grave të tyre.

Shija e qytetërimit, diskursit civil dhe liria brenda saj nuk kanë asnjë efekt tek ta. Diskursi i tyre është vdekjeprurës për lirinë dhe qytetarinë. Është mbytyje e shijes së lirisë. Prandaj duhen ndaluar.

Vjosa, Donika dhe dy burra banalë, ai i Vjosës dhe tjetri i Albulenës janë banaliteti i së keqes. Ata nuk kuptojnë. Përkundër se mund ta dinë çfarë ka ndodhur. Madje njëri prej këtyre burrave ka qenë vetë ushtarë i UÇK-së, prandaj harresa dhe marrosja e tij pas politikës ditore, është më shumë shpjeguese sesa injoranca a mospërjetimi i luftës.

Pak rreshta për këtë katërshe. Kaq meritojnë. Sepse, Ai, i madhërishmi, Albini, nuk është temë. Ai është njeri me halle, të cilat e ka për detyrë t'i zgjidhë.

Në këngën e parafundit të Iliadës, në duelin e famshëm Akil-Hektor, ky i fundit i lutet të mos ia gjymtojë trupin para vdekjes. Prerja e trupit dhe e kujtesës që përfaqëson ai në civilizimin grek, që mbeti rregull për çdo civilizim, si përçues mes botës së gjallë dhe të vdekur, është anti-civilizuese. Ju po e bëni copë trupin e UÇK-së.

I gjithë drejtpeshimi njerëzor i botës, kulturës, lirisë - kujtesa,

morali dhe vetë historia do të merrnin fund në mungesë të respektit për lirinë dhe ata që e bënë kapërcimin nga robërimi në liri.

Fitorja me 52 për qind të votave, për çdo respekt për secilin që arrin në këtë pikë, zakonisht krijon dy efekte: njëri është efekti i vetëkënaqësisë dhe tjetri është ai i nevojës për të përmbysur sisteme. Vjosa, Donika dhe dy burrat banalë dëshirojnë ta përmbysin rrëfimin për lirinë.

Por, ai është i papërmbysshëm. Dhe në atë mision nuk u ndihmojnë as fjalitë që ua shkruajnë të tjerët.

Të gjitha këto rrëfime johistorike, pa gjurmë identike, janë banaliteti i së keqes.

Prandaj, për dy burrat banalë dhe Vjosën e Donikën, duhet një rikujtim historie. Dhe për Glaukun e heshtur, për të cilin rrugës e mësova që është butaku më i dijshtëm e VV-së. Por, fatkeqësia e dijes së tij është mungesa e karakterit. Është e kotë. S'i hyn në punë askujt. As atij.

Vjosë, a e di kush janë UÇK-ja dhe LDK-ja?

Po shkruaj thjesht, që ta kuptosh më lehtë.

Në historinë e jetëve njerëzore ka momente kur vetë historia të këshillojë se për shkak të pafuqisë është e pamundur përmbysja e një pushteti. Duke parë historinë e udhëhequr nga LDK-ja, shqiptarët ishin në ballë të një pyetje monumentale: A duhet të vazhdojmë të jetojmë duke duruar diskriminimin, dhunën dhe poshtërimin, apo duhet ndërmarrë diçka për ta përmbysur atë gjendje? Përgjigja ishte e vështirë. Gjendja ishte bërë e padurueshme. Dhe ndryshimi dukej i pamundur.

Mjaftonin situata ditore, si dalja në rrugë, që ta kuptojë se çdo ndërmarrje për ta sfiduar sistemin shtypës serb do të kishte përfundim tragjik.

Edhe historia nuk jepte shumë shpresa; për të mos thënë që LDK-ja dhe pushteti i saj moral na këshillojnë që ndryshimi është i

pamundur.

Kishte përfunduar keq përpjekja e kaçakëve në Luftërat Ballkanike dhe po aq dëshpërueshëm kishte marrë fund edhe ajo gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë periudhës komuniste robëria dhe dhuna ishin normë jetese.

Vjosë, Donikë dhe ju dy burrat banalë - atëbotë kishte humbur dallimi mes lirisë dhe robërisë. Prandaj, shumë pak prej nesh e donin lirinë me UÇK-në.

Ata që s'e donin edhe sot e shohin luftën me përbuzje. Sepse e donin lirinë e robërisë (aq sa mund të quhet liri). Donin të ecnin me patericat që ua lejonte Sllobodan Millosheviqi.

Ju s'e keni idenë si është të jetosh me dinjitet në paliri. Ti Vjosë je Presidente në emër të UÇK-së. Pa luftën e saj tani mund të ishte duke printuar letra në një zyrë autonomie të Kosovës, apo duke punuar siç punon mërgata, diku në ndonjë qytet të Evropës.

Derisa politikanët e Prishtinës po kalkulonin si tregtarë të zakonshëm rezultatin e secilit veprim, plani genocidal serb po shkonte drejt realizimit. Shqiptarët po shkombëtarizoheshin. Ata që nuk pranonin, shpërnguleheshin.

Për individin kjo është tragjike. Për popujt, fatale.

Në atë gjendje të pashpresë, kur dija nuk vlente më, duhej një çmenduri për ta parandaluar një tragjedi, shkruante një mik i imi, që vazhdonte të më thoshte: "UÇK-ja ishte një grup i të çmendurve, të cilët nuk kishin as minimumin e aftësisë për të llogaritur pasoja, nuk kuptonin asgjë nga formulat juridike, por e kishin kuptuar që ndryshimi brenda letargjisë së krijuar do një veprim praktik dhe bashkë me këtë kishin arritur ta ruanin edhe shijen e lirisë".

Gjërat po ndryshonin. Iluzionet e një Serbie me shqiptarët brenda po shembeshin. Dhe shija e krenarisë po kthehej ngadalë, njëlloj siç e merr veten i sëmuri pas një sëmundje të gjatë dhe të pashpresë.

Por, entuziazmit të krijuar më 28

nëntor 1997, kur për herë të parë u prezantuar para shqiptarëve UÇK-ja, organizatë që bartte mbi supet e veta premtimin për çlirimin e shqiptarëve, i duheshin aksione praktike për të provuar se nuk ka asgjë të pamundur. Nuk vonoi shumë, në shkurt të vitit 1998, Çirezi dhe Likoshani - aksionet e para të UÇK-së, filluan një rrugëtim sa të çmendur, aq edhe të nevojshëm. Për të ardhur te Prekazi heroik dhe te njeriu që do e sfidonte frikën me vdekje - Adem Jashari.

Tanimë nuk kishte kthim prapa. Po shkëputeshin lidhjet me të kaluarën robëruese dhe shqiptarët po e kërkonin një tjetër epokë, një të ardhme në liri.

Kapërcim epokal po dekretohet nga një deklaratë e shkruar me gjak.

Ndërkohë, Vjosë, kasta politike e Prishtinës vazhdonte agoninë, pa arritur të kuptonte se bashkëjetesa dhe rezistenca paqësore nuk kishin më asnjë kuptim.

Madje, aksionet e "çmendura" të UÇK-së i trajtonte me cinizëm, duke lënë të kuptohet se në këtë ndërmarrje nuk shihte asnjë mundësi, duke bërë që mes rreshtave të kuptohet mesazhi: "ne u themi inshallah, por nëse arrini ta realizoni synimin do t'iu themi mashallah". Kaq dhe kështu "kontribuan" pacifistët.

Por, përkundër faktit që të kujdesshmit hezitonin të hidhnin ndonjë hap, "të çmendurit" ishin të vendosur të mos ndaleshin dhe të shkonin deri në fund. Kështu, aksiomën historike "Liria i ka rrënjët në gjak", të parët as nuk guxuan ta mendonin, derisa të dytët e derdhnin pa menduar dy herë.

Ata nuk pritën të piqeshin kushtet sepse e kuptuan, ndoshta me një dozë filozofie, që duke pritur të piqen kushtet, kalbeshin dëshirat. UÇK-ja e parandaloi kalbjen e dëshirave duke krijuar kushtet, pa pritur që të piqeshin.

Gjaku ishte karburanti i vetëm që mund ta lëvizte makinën e amanetit për të arritur te liria. UÇK-ja ishte e vetmja që pranoi të

luftojë edhe kur u shpallën tradhtarë dhe njerëz të UDB-së.

Ata njerëz duruan edhe poshtërimin dhe fyerjet e pushtetit moral të atyre që pinin kafe tarracave të Prishtinës. Dhe është pikërisht një numër i tyre që e ndërjuan rrëfimin për t'i çuar në Hagë, 20 vjet pas çlirimit.

Vjosë dhe Donikë, UÇK tregoi që frika nga gabimi është më shumë gabim se frikë dhe se ishin pikërisht ata që kishin guxim t'i bënin të gjitha gabimet, të njëjtit që e arritën perfeksionin - lirinë.

Në qershor të vitit 1999, Kosova u çlirua, liria erdhi, UÇK-ja e solli dhe kështu u realizua në mënyrën më të përkryer një "çmenduri". Por, bashkë me lirinë erdhi edhe të kuptuarit e gabimeve që ishin bërë përgjatë një shekulli. Miti i lirisë së pamundur ra. Realizimi i saj nuk ishte më një rrëfim i ndaluar. Ne po e jetonim. Po e ndjenim.

Siç më thoshte një mik i imi që e kishte përjetuar UÇK-në me shkronja, duke lexuar historinë e tyre, ka diçka sublime në gjithë këtë histori; "UÇK-ja ka qenë më e madhe nga të gjitha organizimet. E madhe në saje të fuqisë që forcën e ka te pafuqia. E madhe në saje të mençurisë, që sekretin e ka te çmenduria. E madhe në saje të shpresës, trajta e së cilës është marrëzia. E madhe në saje të dashurisë, që ishte urrejtje ndaj vetes".

Prandaj, Vjosë, Donikë dhe ju dy burrat banalë, në diskursin që synon ta njollosë UÇK-në dallohet qartë tentimi për ta relativizuar faktin që në atë luftë të pabarabartë kishte një viktimë dhe një agresor.

Përballë kësaj orkestre shpifëse të udhëhequr nga ju (në vend që të krenoheni me luftën), s'ke si të mos të kujtohet dhe të mos i japësh të drejtë shprehjes së famshme se viktimë e parë e çdo lufte është e vërteta. Nëse i lexoni këta rreshta, sepse nuk e kuptoni çfarë ka ndodhur në këtë vend, mos harroni t'ua përcillni edhe atyre dy burrave banalë.

(Marrë nga Albanian Post)

Thaçi, Veseli, Krasniqi, Selimi, Ngucati, Haradinaj e të tjerët po mbahen padrejtësisht në Hagë

DRENAS, 14 QERSHOR (ER) - Me rastin e shënimit të 22-vjetorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Drenasit, është mbajtur seanca solemne e Kuvendit të Komunës, ku janë nderuar të gjithë dëshmorët. Në seancën solemne kanë marrë pjesë kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, anëtarë të Kuvendit dhe drejtorë të drejtorive komunale.

Seanca është udhëhequr nga kryesuesi Labinot Halilaj, i cili ka thënë se 14 qershori mbetet datë krenarie që na kujton shpresën për jetë të lirë të kërkuar me shekuj nga atdhetarë të vendit. "Sot është dita më e rëndësishme historike e qytetit tonë, pra



është Dita e Çlirimit të Drenasit, dita e dëbimit të ushtarit të fundit serb nga qyteti ynë i datës së 14

qershorit të vitit 1999. Shënimi i kësaj date në mënyrë institucionale dhe shtetërore e madhëson luftën dhe

sakrificat e popullit për çlirim, lirisë së vendit i jep kuptimin e plotë, ndërsa popullit i shton dashurinë ndaj atdheut. Rruga

deri te kjo datë ishte shumë e gjatë, e mbushur me plot dhimbje, vuajtje e sakrificat për popullin tonë, po aq e gjatë e më dhimbje sa edhe sot kur ne festojmë këtë datë madhështore, çlirimtarët tanë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Hysni Ngucati, Nasim Haradinaj e të tjerë, mbahen padrejtësisht në Hagë të akuzuar gjoja për krime lufte", ka thënë kryesuesi Halilaj. Ndërsa kryetari Ramiz Lladrovci, në fjalimin e tij në këtë seancë, ka thënë se Dita e Çlirimit është data kur me nderim të thellë kujtojmë gjithë sakrificën e qytetarëve të Drenasit, heronjtë, dëshmorët dhe martirët e lirisë.

Sot fillon vaksinimi masiv i qytetarëve të Mitrovicës

MITROVICË, 14 QERSHOR (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, është mbajtur të hënën mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, ku temë kryesore për diskutim ishin organizimi i dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe planifikimi për vaksinimin masiv të qytetarëve të Mitrovicës që nga data 15 qershor 2021.

Drejtoresha për Shëndetësi, Erseka Hasanaj-Barani, ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura që më 15 qershor të fillojë vaksinimi masiv i qytetarëve në bazë të kriterëve për vaksinim në Qendrën e Kulturës "Rexhep

Mitrovica", që do të bëhet nga 12 ekipe të vaksinimit të QKMF-së. Ajo ka potencuar se vaksinimi do të bëhet për personat e moshës 18 e lartë (me sëmundje kronike). "Vaksinimi do të bëhet nga e hëna deri të premten, nga ora 07:00-19:00, ku pas vaksinimit stafi shëndetësor do ta përcjellë gjendjen e pacientit për 5-7 minuta. Po ashtu, QKMF-ja ka vendosur edhe një numër kontaktues për çfarëdo informate që u duhet qytetarëve. Ndërsa sa iu përket terminëve për marrjen e vaksinës janë të obligueshme ta bëjnë dhe duhet të bëhen në platformën elektronike në <https://ekosova.rks-gov.net>",



ka theksuar drejtoresha Bahtiri u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Mitrovicës që ta kryejnë vaksinimin,

sepe është e vetmja mënyrë për ta mundur virusin Covid-19.

sepe është e vetmja mënyrë për ta mundur virusin Covid-19.



Shyhrete Bajrami bëhet pjesë e AAK-së në garën për Asamblenë Komunale në Prishtinë

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Kandidati për kryetar të Prishtinës nga radhët e AAK-së, Daut Haradinaj, ka bërë me dije se garës për Prishtinën i bashkohet edhe

Shyhrete Bajrami, me profesion juriste si dhe aktiviste e hershme e kësaj partie. "Me kandidaturën e saj për Asamblenë Komunale të kryeqytetit, përfaqësimi i

Gollakut dhe veçmas i Keqekollës do të jetë shtytje për zhvillimin e kësaj zone. Suksese e na priftë e mbara!", ka shkruar Daut Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Asamblisti i Nismës në Gjakovë kalon në Vetëvendosje

GJAKOVË, 14 QERSHOR (ER) - Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës së Gjakovës i është bashkuar asamblisti i Nismës Socialdemokrate, Demë Avidjaj, me profesion ekonomist dhe është i punësuar në KRU

"Gjakova". "Si kandidat për asamblenë komunale nga radhët e Nismës Socialdemokrate ka dalë më i votuari brenda këtij subjekti në zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe së fundi është zgjedhur nënkryetar i këtij subjekti në Gjakovë.

Demës i urojmë mirëseardhje dhe bashkë me asamblistët e deritanishëm të LV-së do të angazhohemi që t'ua kthejmë dinjitetin qytetarëve", është thënë në njoftimin e LV-së, dega në Gjakovë.





Opozita kërkon nga qeveria ta implementojë Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës, nën drejtimin e nënkrytares Saranda Bogujevci, ka vazhduar të hënën punimet e seancës plenare të datës 11 qershor. Seanca ka vazhduar me shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka prezantuar dhe arsyetuar ndryshimet në këtë projektligj, duke thënë se një lëshim teknik që është bërë në ligjin aktual pamundëson suspendimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kur ndaj tyre është iniciuar procedurë disiplinore. “Ky projektligj ka për qëllim evitimin e të metave dhe problemeve të hasura në praktikë lidhur me zhvillimin e procedurës disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë. Nuk ka implikime buxhetore, prandaj ftoj deputetët që ta votojnë”, ka thënë Haxhiu.

Pas prezantimit nga ana e Haxhiut, u deklaruan edhe kryetarët e grupeve parlamentare, të cilët i dhanë mbështetje ndryshimit të projektligjit. Pas hedhjes në votim, Projektligji nr. 08/L-003

për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve u miratua në parim.

Seanca ka vazhduar me shqyrtimin e raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2020, të cilin para deputetëve e rekomanduan për votim kryetari i Komisionit për Siguri dhe Çështje të Mbrojtjes, Bekë Berisha dhe ai i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Armend Muja.

Raporti vjetor i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2020 mori mbështetjen e Kuvendit me votat për të 76 deputetëve që votuan.

Seanca pastaj ka vazhduar punimet me debatin parlamentar në lidhje me situatën ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19, kërkesë kjo e grupit parlamentar të Partisë Demokratike e Kosovës.

Në cilësinë e iniciuesit, deputeti Bedri Hamza ka thënë se gjendja ekonomike është e rëndë dhe se qeveria, sipas tij, duhet të fillojë me implementimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, pasi që pas gjashtë muajve ky ligj do të shfuqizohet. “Se gjendja ekonomike është e rëndë, tregojnë edhe shumë indikatorë makro-ekonomikë. Kemi shumë biznese që kanë

falimentuar e shumë punëtorë që kanë humbur vendin e tyre të punës. Ndërsa borxhi publik është rritur. Shqetësuese mbetet që as në programin qeveritar nuk parashihet asnjë masë konkrete se si do të bëhet rimëkëmbja ekonomike e vendit pas Covid-19”, ka thënë deputeti Hamza.

Me këtë rast, ai ka paraqitur edhe një rezolutë me anë të së cilës ka kërkuar që pagat e punëtorëve të sektorit privat të jenë 300 euro në muaj, të ketë mbështetje shtesë prej 40 milionë eurove për të gjitha bizneset që kanë qenë të mbyllura e nuk kanë funksionuar në rregull gjatë pandemisë; të gjithë përfituesit e skemave sociale të paguhen shtesë me nga 100 euro për muajin maj, qershor, korrik, gusht dhe të parashihet falja e gjobave në kohë pandemie, ndërsa ata që i kanë paguar, t’u rimbursohen.

Pas prezantimit të arsyetimit të debatit, fjalën e morën përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Mimoza Kusari-Lila nga Vetëvendosja ka kërkuar që të bëhet debat në bazë të planifikimeve dhe jo në bazë të agjendës politike sa i përket gjendjes ekonomike në pandemi. “Është mëkat që të mos vlerësohet puna e qeverisë. Nënshkrimi i kontratës për furnizim me

vaksina e ulja e rasteve të infektuara me Covid-19, rritja e aktivitetit ekonomik, skema e punësimit të rinjve, ndihma dhe asistencë për gratë në biznes, në aftësimin profesional për punësim etj., janë disa nga rezultatet që janë bërë falë punës së qeverisë”, ka thënë Kusari-Lila.

Ndërsa nga Lidhja Demokratike e Kosovës, deputetja Hykmete Bajrami ka vlerësuar se as rënia e numrit të rasteve të infektuara me Covid-19 e as rimëkëmbja ekonomike nuk është meritë e qeverisë aktuale. “Me rënien e numrave të infektuarve është e pakuptueshme që të krenoheni aq shumë, se nuk ka asnjë vendim e asnjë masë që ju të merrni merito. Nëse flasim për shifrat e majit, nuk ka masë ekonomike dhe vendim që efektet do t’i krijonte menjëherë pas një muaji”, ka thënë Bajrami.

Ndërsa deputeti nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj ka thënë se nga qeveria Kurti nuk ka parë ndonjë planifikim ekonomik për t’u dalë në ndihmë bizneseve dhe qytetarëve, ndërsa ka shtuar se me këtë qeveri situata po përkeqësohet çdo ditë e më shumë. “Situata po përkeqësohet çdo ditë e më shumë. Pushteti lokal është përballur me vështirësi si

rezultat i ndryshimeve thelbësore në buxhet dhe menaxhim financiar dhe qytetari është duke pësuar”, është shprehur Lekaj.

Pas deklarimeve të përfaqësuesve të partive parlamentare, para deputetëve ka folur ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cili ka paralajmëruar pako të re të rimëkëmbjes ekonomike, paralelisht me rishikimin e buxhetit, për të cilët ka thënë se shumë shpejt do të jenë në Kuvend për votim. “Ne jemi në përgatitje. Shumë shpejt do ta kenë edhe rishikimin e buxhetit. Ka qenë e pamundur të hartohet pakoja e rimëkëmbjes ekonomike pa e ditur hapësirën fiskale. Është dashur t’i monitorojmë të hyrat dhe shpenzimet në mënyrë që ta kemi të qartë se çfarë hapësire fiskale mund të përdorim për të krijuar këtë pako të rimëkëmbjes. Shumë shpejt, paralelisht do t’i kemi të dyja”, ka thënë Murati.

Ai ka kritikuar qeverinë e kaluar për masat e ndërmarra për ndihmë bizneseve.

Për situatën në ekonomi gjatë pandemisë, diskutuan edhe deputetët nga opozita dhe opozita. Pas diskutimeve, iniciuesi i debatit, deputeti Hamza, ka kërkuar që votimi i propozimrezolutës të shtyhet për seancën e ardhshme.

OAK-u: Qeveria të ketë menaxhim më të mirë të parasë dhe pronës publike

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të ketë menaxhim më të mirë të parasë dhe pronës publike.

OAK-u ka theksuar diskrepancën ndërmjet sektorit publik dhe privat sa iu përket pagave mesatare në vend. "Diskrepanca e madhe mes pagave në sektorin

publik dhe sektorit privat dita-ditës po thellohet dhe po paraqet një mosbarazi edhe më të madhe për të punësuarit në këta sektorë. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) për vitin 2020, del se paga mesatare bruto në Kosovë për vitin 2020 ishte 466 euro, përderisa paga mesatare bruto në sektorin privat për vitin 2020 ishte 380 euro, paga mesatare bruto në

sektorin publik ishte 624 euro, ndërsa te ndërmarrjet publike paga mesatare bruto ishte 769 euro", është thënë në komunikatën e OAK-ut. Oda e Afarizmit e Kosovës ka shprehur shqetësimin për këtë diskrepancë të krijuar ndër vite mes pagave të sektorit publik dhe atij privat. "Sektori publik edhe më tutje po vazhdon të favorizohet në paga, edhe pse ata paguhen nga tatimet e qytetarëve të Republikës së

Kosovës, duke vënë kështu të punësuarit në sektorin privat në një pozitë më pak të favorshme krahasuar me ata të sektorit publik. Mes dy sektorëve, ekziston një konkurrencë dhe ndikim reciprok, duke bërë që të punësuarit profesionalë të jenë më të tërhequr për të punuar në sektorin publik. E që, në fakt, duhet të bëhet e kundërta, sektori publik është i stërmbushur dhe të rinjtë duhet të orientohen

drejt sektorit privat, duket ofruar kështu më shumë mundësi për ngritje dhe zhvillim", është thënë në këtë komunikatë.

Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) si përfaqësuese e qindra bizneseve vendore ka kërkuar që prioritet i vendit tonë të jetë mirëqenia e tërë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe rritja e punësimit, e jo vetëm mirëqenia e atyre që janë të punësuar në shtet.




Sektori i furnizimit me rrymë shënon rritje

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën afatshkurtra të industrisë, duke paraqitur indeksin e vëllimit industrial për TM1 2021 (2017=100). Kjo anketë, me të dhënat që ofron, synon ta paraqesë ecurinë në industri: B - Nxjerrëse, C - Përpunuese, D - Furnizim me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, dhe E - Furnizim me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave, në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave

kuptohet zhvillimi i ciklit në industri. Sipas ASK-së, në tremujorin e parë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin e katërt 2020, pati rritje në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me 7.13 për qind. "Kurse, po në këtë periudhë kishin ulje sektorët e: industrisë nxjerrëse (B) me (-27.50 për qind); industrisë përpunuese (C) me (-23.08 për qind); dhe sektori i furnizimit me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) me (-1.34 për

qind). Krahasuar TM1 2021 me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM1 2021), kishte rritje në: sektorin e industrisë përpunuese (C) me 19.29 për qind; sektorin e industrisë nxjerrëse (B) me 15.05 për qind; sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me 8.07 për qind", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se ulje kishte në sektorin e furnizimit me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) për (-3.92 për qind).





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Spanja gabon ndaj Suedisë



Seville, 14 qershor - Spanja nuk ka mundur të shkojë më shumë se një barazim pa gola në duelin e parë kundër Suedisë. Skuadra e Enriques zhvilloi një lojë të dobët, duke krijuar shumë pak shanse, kryesisht në fraksionin e parë. Ndeshja nisi më mirë për Spanjën, që krijoi shansin e parë për shënim në minutën 17-të. Dani Olmo kishte mundësinë për të gjetur golin me kokë, port portieri Olsen i mohoi golin me një zgjatje fantastike. 5 minuta më pas Koke shpërdoroi një rast brenda zonës, duke goditur jashtë kuadrantit. Skuadra e Enriques humbi edhe raste të tjera. Alvaro Morata në të 38-tën, i vetëm përballë portierit e çoi sferën ngjitur me shtyllën. Suedia në krahun tjetër krijoi pak në 45 minutat e para, por në fakt kishte rastin më të pastër. Alexander Isak u ndal nga Llorente dhe shtylla, teksa nuk i besonte syve kur pa topin që nuk shkoi në rrjetë. Spanja nuk luan aspak mirë në fraksionin e dytë, duke shfaqur vështirësi të mëdha në krijimin e aksioneve. As zëvendësimet nuk sollën asgjë. Në krahun tjetër Isak dhuron spektakël në zonë, shërben për Berg, i cili me portën e

boshatisur, bën më të vështirën, duke e dërguar topin jashtë. Në minutën e 90-të, Robin Olsen ndal Gerard Morenon me një pritje të bukur. Kujtojmë që ky është barazimi i parë në këtë edicion të Evropianit. Në Grupin E udhëheq Sllovakia me 3 pikë, e ndjekur nga Suedia dhe Spanja me 1 pikë.

Polonia zhgënjën ndaj Sllovakisë

Polonia zhgënjën që në sfidën e parë në "Euro 2020", duke pësuar një humbje 1-2 në Shën Petersburg. Skuadra e Paulo Sosas, tregoi mangësi të mëdha në mbrojtje duke ja bërë më të thjeshtë triumfin kundërshtarëve. Në minutën e 18-të, Robert Mak i shkëputet mjaft mirë mbrojtjes së polakëve dhe më pas lëshon një goditje të fortë, që nuk arrin të ndalet në mënyrën më të mirë nga portieri Szczesny. "Gardiani" i Juventusit shkaktoi autogolin e parë historinë e Evropianeve nga portierët. Polonia reagoi vetëm në fillimin e pjesës së dytë me një aksion shumë të bukur. Pas vetëm 30 sekondash, Linetty ishte në kohën dhe në vendin e

duhur në zonë, për të finalizuar aksionin që zgjati me shumë pasime. Në të 62-ën, Krychowiak komplikon sfidën e polakëve, duke marrë kartonin e dytë të verdhë, duke lënë shokët me një futbollistë më pak. Sllovakia e shfrytëzoi në mënyrën më të mirë, duke rigjetur avantazhin në minutën e 69-të. Pas një goditje nga këndi, Milan Skriniar bën sulmuesin duke kontrolluar fillimisht topin dhe më pas godet mjaft mirë në cepin e portës. Lewandowski nuk mundi të linte shenjë në këtë ndeshje, teksa tashmë Polonia e tij rrezikon eliminimin.

Çekia mposhti Skocinë

Republika Çeke ka shënuar fitore shumë të rëndësishme në përballje me Skocinë (0-2), në ndeshjen e vlefshme për Grupin D në Kampionatin Evropian "Euro 2020". Në minutën e 42-të, Patrik Schick i kaloi çekët në epërsi 0-1. Në fillim të pjesës së dytë i njëjti futbollist shfrytëzoi një dalje të portierit David Marshall dhe realizoi gol pothuajse nga gjysma e fushës për rezultatin final 0-2.



Eriksen: Dua të kuptoj se çfarë ndodhi, do të rikthehem në stërvitje

Pasditen e së shtunës bota e sportit, por jo vetëm, mbeti e shokuar pasi mesfushori i Danimarkës humbi ndjenjat në fushën e lojës në ndeshjen me Finlandën në "Euro 2020". Por, për fatin e mirë të tij, duket se gjithçka ka kaluar dhe ai është përmirësuar ndjeshëm falë edhe reagimit të duhur dhe në kohë të mjekëve dhe shokëve të ekipit. Me anë të agjentit të tij, Martin Shots, Eriksen ka reaguar në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport". "Ai ndihej i lumtur sepse pa përreth shumë njerëz që treguan dashuri ndaj tij. Atij i kanë ardhur shumë mesazhe nga e gjithë bota, jo vetëm nga shokët e skuadrës, por edhe nga tifozët", ka thënë Shots. Më tej, ai zbulon edhe bisedën që Erikseni pati me shokët e ekipit nga spitali. "Si jeni? E ndiej që jeni më keq se unë. Unë nuk dorëzohem. Jam gati për t'u stërvitur".

Verrati rikthehet për ndeshjen ndaj Zvicrës

Italia, pas fitores ndaj Turisë në ndeshjen e parë, mori një lajm të mirë. Fjala është se ylli i mesfushës, Marco Verrati, është gati për ndeshjen e dytë ndaj Zvicrës, e cila zhvillohet më 16 qershor. "Marco po përmirësohet çdo ditë dhe fakti që dje mori pjesë edhe në ndeshjen brenda grupit, pa probleme e shqetësime, na bëjnë shumë optimistë se riaftësimi i tij është kompletuar. Pa dyshim se nuk kemi pse të nxitohemi për askënd, por mendoj se Mancini mund të nisë ta llogarisë edhe Verratin për Zvicrën", ka thënë mjeku Andrea Ferretti.

De Ligt, i gatshëm për Austrinë

Lajm i mirë nga grumbullimi i Holandës në lidhje me gjendjen fizike të Matthijs De Ligt: mbrojtësi i Juventusit ka lënë pas dëmtimin në rrëzë të kofshës. Një lajm i shkëlqyer nga infermiera e "tulipanëve", pasi trajneri Frank de Boer tani do të ketë në dispozicion një element thelbësor që do të japë shumë më tepër siguri në lojën mbrojtëse duke nisur që nga përplasja e radhës me Austrinë. Kujtojmë që në sfidën e parë ndaj Ukrainës, e fituar 3-2 nga Holanda, skuadra e de Boer pësoi dy gola që tregoi dobësitë që ka kjo skuadër në prapavijë kur nuk luan de Ligt, aq më tepër që për arsye dëmtimi nuk ka humbur Evropianin edhe Virgil van Dijk. Holanda, pas suksesit të arritur ndaj Ukrainës, mund të konsiderohet e kualifikuar në fazën tjetër, pasi vështirë se do të dështojë të marrë pikë me Austrinë apo Maqedoninë e Veriut.

Dion Ajvazi i thotë po Kosovës

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, bashkë me nënkryetarin e parë të FFK-së, Agim Dibrani, pritën sot në takim Dion Ajvazin, futbollistin me prejardhje nga Kosova, i cili karrierën po e zhvillon në

Gjermani. 17-vjeçari, i cili aktualisht luan te Hertha BSC U17, i është përgjigjur pozitivisht Kosovës. Mesfushori Ajvazi shumë shpejt do t'i bashkohet Përfaqësueses U19 për ta dhënë kontributin e tij në fushën e blertë. Dioni u

shpreh i lumtur që do t'i bashkohet Kosovës dhe shprehu gatishmërinë për ta dhënë maksimumin. Ndërsa kryetari Ademi, në shenjë mirëseardhjeje, i dhuroi fanellën e re të Kosovës dhe i uroi shumë suksese. FFK-ja

edhe më tej vazhdon të interesohet për talentet e saj jashtë kufijve. Qëllimi mbetet i njëjtë, t'i bashkojë të gjithë ata që zemra u rrah për Kosovën dhe që ndër prioritetet e tyre është kontributi për fanellën dardane.



Kosova fiton pesë medalje në Kampionatin Ballkanik të Bodybuildingut

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Garuesit e Kosovës që morën pjesë në Kampionatin Ballkanik në Bodybuilding dhe Fitness kanë arritur që të kthehen me pesë medalje, prej tyre tri të arta dhe dy të argjenta. Në garën e zhvilluar në qytetin Dobreta - Turnu Severin të Rumanisë, gjatë kësaj fundjave medaljen e artë për seniorë e fitoi Kushtrim Bajraktari në kategorinë bodybuilding (-80 kg), teksa i njëjti e ka fituar edhe kupën në kategorinë absolute njëkohësisht duke u shpallur "Garuesi më i mirë i kampionatit". Medalje të arta fituan edhe Granit Kuleta (-90 kg) dhe Arton Koci në kategorinë "Classic". Teksa medalja e argjente në kategorinë "Physique" -175 cm shkoi për Pllumb Latifin. Në



grupmoshën U-20 të argjente dhe fitoi Fatlind Kërçeli, kategoria "Physique". Pjesëmarrjen e ekspeditës së Kosovës në Kampionatin Ballkanik e ka përkrahur edhe Komiteti Olimpik i Kosovës duke dhënë në shfrytëzim veturën për udhëtim.

Phoenixi në finalen e Perëndimit, Bucks barazon serinë kundër Netsit

Phoenix, 14 qershor - Phoenix Suns është skuadra më e mirë në NBA. Pasi eliminoi kampionët në fuqi të Los Angeles Lakersit, ekipi nga Arizona likuidoi shumë shpejt edhe Denver Nuggetsin duke u kualifikuar në finalen e Konferencës së Perëndimit, aty ku do të përballlet me fituesen e çiftit Utah Jazz - Los Angeles Clippers. Në "Ball Arena" në Colorado, Phoenix Suns, falë paraqitjes së shkëlqyer të dyshes Chris Paul - Davon Booker, arriti të triumfojë me rezultatin 125-118, duke mbyllur 4-0 serinë e përballjeve gjysmëfinale mes tyre. Veterani Paul ishte thjesht fantastik në këtë duel me 37 pikë, 3 rebounde e 7 asistime, ndërkohë që shumë i vyer për skuadrën nga Arizona ishte edhe kontributi i dhënë nga Davon Booker i cili spikati me 34 pikë, 11 rebounde dhe 7 asistime. 25 pikët e Bartonit dhe 22 të Jokiçit ishin të pamjaftueshme për Nuggetsin i cili u dorëzua pa kushte edhe në këtë sfidë të 4-t ndaj Phoenixit duke pësuar kështu një eliminim të turpshëm pa marrë asnjë fitore, raporton "Supersport". Nuk fali as në ndeshjen e dytë shtëpiake Milwaukee Bucks që barazoi në 2-2 serinë e



gjysmëfinaleve të Lindjes ndaj Brooklyn Netsit. Në Fiserv Forum skuadra e trajnerit Mike Budenholzer triumfoi me rezultatin 107-96 në një ndeshje ku Milwaukee e bëri dallimin në periodën e dytë dhe të tretë në të cilat dominoi me lojë dhe rezultat. Giannis Antetokounmo ishte më i miri i sfidës teksa koleksionoi në total 34

pikë, 12 rebounde dhe 3 asistime, ndërkohë që te Netsat më i miri mbi parket ishte Kevin Durant, autor i 28 pikëve. Katër përballjet e para në serinë mes Bucksit dhe Brooklynit janë fituar nga skuadrat vendase, mbetet për t'u parë nëse parketi do të rezultojë deçiziv deri në fund pasi Brooklyn do të luajë një ndeshje më shumë në shtëpi se Milwaukee.

SHKURT

Ramadani paraqitet te MTK Budapest

Ylber Ramadani është lojtari tjetër i kombëtares shqiptare që transferohet në Hungari. Mesfushori ka firmosur me MTK Budapest dhe do të kërkojë të tregojë vlerat e tij, në një kampionat ku luajnë edhe Myrto Uzuni, Hysen Memolla, Herdi Prenga dhe Jasir Asani. Mesfushori ka spikatur në katër sezone me Vejle BK, skuadër së cilës iu bashkua pas sezonit të parë në Superiore me Partizanin. Më pas ai fitoi edhe një vend në kombëtaren e Shqipërisë.

Arsenali edhe një herë e refuzon ofertën e Mourinhos për Xhakën

Skuadra e Arsenalit e ka refuzuar një ofertë të tretë të Jose Mourinhos, i cili me ngulmë është duke e kërkuar futbollistin shqiptar në skuadrën e Romës. Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, nuk është i impresionuar me ofertat e deritanishme për 28-vjeçarin, shkruan "Daily Star". Një lojtar me të cilin Arsenali po kërkon ta zëvendësojë Xhakën është Ruben Neves i Wolves. Por, rivalët e Premierë Ligës, Manchester Unitedi, gjithashtu ka hyrë në garë për yllin portugez.

Messi: Gjithmonë jam gati për Argjentinën

Leo Messi, sulmuesi i Argjentinës, ëndërron të fitojë me kombëtaren e tij. Shpesh ia përmendin që nuk ia ka dalë të marrë një trofe të rëndësishëm. Sulmuesi ka folur dhe thekson se nuk do të ndalet për ta arritur diçka të tillë. "Jam gjithmonë në dispozicion të kombëtares së Argjentinës. Ëndërra më e madhe është të fitoj një trofe me këtë fanellë. Kam qenë pranë disa herë. Nuk ndodhi, por do të përpiqem të ndodhë. Gjithmonë do të luftoj për këtë ëndërr", ka thënë Messi.

Garat e Suzukas dhe Melburnit në dyshim, Formula 1 mendon për pistat rezervë

Sezoni 2021 i Formulës 1 ka pësuar disa modifikime në kalendar për shkak të pandemisë Covid-19. Gjithsesi, të tjera modifikime priten muajt në vijim, duke qenë se sezoni është i gjatë dhe me 23 gara (rekord). Sipas mediave gjermane, garat e Suzukas (Japoni) dhe Melburnit (Australi) janë ende në dilemë për shkak të masave të rrepta anti-Covid që janë ende në fuqi në këto shtete. Për këtë arsye, ato mund të anulohen. Mediat konfirmojnë se janë disa opsione për t'i zëvendësuar pistat në dyshim. Gjithsesi, ideja më e pranueshme është të zhvillohen dy gara në Lindjen e Mesme, në Bahrein (pista e Sakhir) dhe Katar (pista e Losail).

Ancelotti, kërkesë Realit: Ma silleni Wernerin

Trajneri i ri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka një kërkesë në lidhje me merkaton. "Fichajes" raporton se Ancelotti i ka kërkuar presidentit Florentino Perez t'i sjellë në skuadër

Timo Werner, sulmuesin e Chelseas. 25-vjeçari gjerman u transferua verën e vitit të kaluar nga Leipzig u te "Blutë e Londrës" për shumën e 53 milionë euro. Përshtatja në Premierë

Ligë nuk ishte e thjeshtë. Werner ka hasur vështirësi, por në fazën e dytë të sezonit ngriti nivelin e tij të lojës dhe ia doli ta fitojë Ligën e Kampionëve me skuadrën londineze.

Ancelotti i pëlqen shumë karakteristikat e lojtarit të kombëtares gjermane dhe te Reali po përgatitin ofertën e parë në drejtim të tij dhe Chelseas.



Kryetari i Komunës – Suharekë 01-nr.465- 32890 Dt. 09. 06. 2021

Ne kuptim të nenit 11, lidhur me nenin 4 te Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme Nr.03/L-139 dt. 26.mars 2009 te Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme nr.03/L-205 dt.10.dhjetor 2010, nenit 44 te Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative O/L-031, pas shqyrtimit te komenteve dhe deklarave te palëve, brenda afatit ligjor, si dhe duke u bazuar ne Vendimin e Kuvendit te Komunës 01.nr.016-53056, dt.30.10.2020 per shpallje te interesit publik, Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim 01 nr.016-50801, dt. 03.07.2019 dhe Vendimin (korigjues) 01 nr.465-29472, dt. 20.05.2021, Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit te propozuar 01. nr.465-72396, dt. 16.09.2019 dhe Vendimin Preliminar (korigjues) 01. nr.465-29468-72 dt. 20.05.2021 për shpronësimin e palujtshmerisë për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. Shpronësohet palujtshmeria për interes publik dhe për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës në Suharekë e cila gjindet në ngastrën kadastrale me nr. P-72116046-02816-4, në sip. prej: **51 m2** dhe në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116046-02816-7, në sip. prej: **478.50 m2. evidentuar në emër të Muhamet (Xhemajli) Elishani, Zk. Suharekë.**

II. Vërtetohet se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në Suharekë është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur është në shërbim te arritjes së këtij qëllimi.

III. Pronari i palujtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, kompenzohet konform aktit te vlerësimi te punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës se Paluajtshme (Ministra e Financa), si vijon:

- Për pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116046-02816-7, lartësia e qmimit për 1.(m2) është vlerësuar **52.00 (€/m2) X 478.50 m2, = 24.882.00 €** (Njzet e katërmij e tetqind e tetdhje e dy €),

- Për ngastrën kadastrale me nr. P-72116046-02816-4, lartësia e qmimit për 1.(m2) është vlerësuar **50.00 (€/m2) X 51 m2, = 2,550.00 €** (Dymij e pesqind e pesëdhjet €).

V. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Arsyetim

Subjekti kërkuar-Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës, me kërkesën 01 nr.104-48631, datë 12.10.2020 ka kerkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës inicimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për realizimin e projektit për ndërtim dhe zgjerimin e rrugës publike si në dispozitiv te këtij Vendimi.

Subjekti kërkuar, kësaj kerkese ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshem i cili parashihet me dispozitat e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit te kërkesës ka konstatuar se shpronësimi i palujtshmerisë te evidentuar ne dispozitiv te këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës se paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme te Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen ne Vendimin Përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkuar për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 15 ditëve kalendrike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi i dërgohet:

Subjektit kërkuar

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit



Kryetari i Komunës 01-nr.465- 32892 Dt.10.06.2021 - S u h a r e k ë

Në bazë të nenit 4 pika 2, 2.4 dhe 3.3, n nenit 8 pika 5, të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshim dhe plotësim e bëra me Ligjin Nr-03/L-205, dhe nenit 44 të LPPA-së nr-05/ L.031, dhe kërkesës së subjektit kërkuar-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës nr.01-104-32798, datë 10.06.2021 për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në ZK.Sopijë, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë :

VENDIM

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës se subjektit kërkuar-Drejtorisë për shërbime Publike e Komunës së Suharekës, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, pronë private e pronarve dhe zotëruesve të interesit, për interes publik dhe për ndërtimin dhe zgjerimin e rruges publike e cila gjindet në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116043-00862-0, në sip. prej: **55 m2, ne vendin e quajtur "Drum-Shirokë e evidentuara sipas qertifikatës së pronë emër të Hamdi (Fejz) Berishaj, ZK. Sopjë.**

2. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtij Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësim e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodeve dhe kriterëve teknike te vlersimit qe do të perdorën për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme qe shpronësohet dhe dëmeve qe kanë të bëjnë me shpronësimin.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër te Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

4. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e publikimit ne Gazetën zyrtare të Kosovës dhe ne një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

Iu dërgohet:
Subjektit kërkuar;

Pronarit dhe zotëruesit të interesit,

Arkivit.

Kryetari i Komunës
Bali Muharremaj



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e një (1) anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

Një (1) anëtar/e, përfaqësues nga shoqëria civile.

I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku pesë (5) vjet;
5. Të ketë përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 29.06.2021, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

K O N K U R S

Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog Saveta Kosova, predstavnika civilnog društva

Shodno članovima 9. i 10. Zakona 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjenja zakonske obaveze da se izabere član Tužilačkog saveta Kosova, Skupština objavljuje konkurs za popunu radnog mesta:

Jedan (1) član/ica, predstavnik/ica civilnog društva.

I. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Kosova, treba da ispuni sledeće uslove:

1. Da bude državljanin i stanovnik Republike Kosovo;
2. Da ima visoku stručnu spremu u oblasti pravde;
3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
4. Da ima radno iskustvo u pravnim pitanjima najmanje pet (5) godina;
5. Da imaju podršku najmanje pet (5) organizacija civilnog društva na polju pravde;
6. Da nije osuđen za krivično delo.

II. Civilno društvo u spisku kandidata nominovanih za člana mora priložiti i dokumente koji dokazuju da kandidat ispunjava uslove predstavljene u ovom javnom oglasu.

III. Skupština Kosova podstiče civilno društvo, kada podnosi predloge za člana TSK-a, da uzme u obzir multietnički sastav Republike Kosovo i prihvaćene principe rodne ravnopravnosti.

Aplikaciji se treba priložiti i sledeći prateći dokumenti:

- Biografija (Curriculum vitae);
- Potvrda o školskoj i profesionalnoj pripremi (diplome univerziteta u inostranstvu mora nostrifikovati Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 29.06.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažnim.


Lajmërojmë

Bashkëpronarit LATIF (RUSTEM) DESTANI, nga Fshati Zojz – Prizren, **si Blerësit potencial se, ne** Bashkëpronarët Dragisha Mitroviq, Sasha Mitroviq Dragan Mitroviq dhe Rajko Mitroviq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër **P-71813028-00293**, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej **20919 m2** të gjitha në Zonën Kadastrale Zojz - Prizren, **Po i Shesim - pjesët tona bashkëpronësore.**

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të me lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: Rr. "Fehmi Lladrovci" nr.70- Prizren.

Njëherit informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 20.000.00 € (njëzetë mijë euro) me para të gatshme – në kesh.

Telefoni kontaktues: +383 (0) 44/351-471



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Minire Byryqi shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit "Kadri Zeka" Gjilan.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE

